



KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Politikën e Jashtme

Dokument parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.139/2015, “PËR VETËQEVERISJEN VENDORE”

❖ **HYRJE**

Komisioni për Politikën e Jashtme, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 10.06.2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”. Komisioni për Politikën e Jashtme caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Adnor Shameti.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm Z. Pandeli Majko, Ministër i Shtetit për Diasporën dhe përfaqësues të Ministrisë për Financat dhe Ekonominë.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Nga analiza e nenit 81, pika 2, të Kushtetutës dhe përmbajtjes konkrete të këtij projektligji, rezultojnë se fusha që rregullon ky projektligj nuk përfshihet në çështjet që trajton kjo dispozitë kushtetuese, e për pasojë miratimi i këtij projektligji i nënshtrohet rregullit të përgjithshëm për sa i përket shumicës.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i propozuar “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ka si qëllim që nëpërmjet ndryshimeve të propozuara, të nxisë dhe fuqizojë bashkëpunimin në të gjitha fushat me shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe

shtetet ku ata banojnë, si dhe të mbrojnë interesat e shtetit brenda fushave të përgjegjesisë. Vetëqeverisja Vendore aktualisht është rregulluar nëpërmjet ligjit Nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”. Gjatë zbatimit të këtij ligji është evidentuar nevoja për implementimin e plotë të dispozitave kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve që jetojnë jashtë kufijve, si edhe nevoja për krijimin e mekanizmave ligjorë në nivel vendor sa i takon zhvillimit të raporteve me diasporën.

Me qëllim plotësimin e nevojave të lart-përmendura Këshilli i Ministrave ka ndërmarrë nismën ligjore për disa shtesa dhe ndryshime në projektligjin ekzistues, duke e konsideruar përcaktimin e strukturave shtetërore përgjegjëse për marrëdhëniet me diasporën një instrument kyç në realizimin e angazhimit politik për të mbështetur e përkrahur komunitetin shqiptar jashtë vendit.

Në ndryshim nga ligji aktual, projektligji i propozuar parashikon **ndryshimet** si më poshtë:

- **Në nenin 1** parashikohet që pas nenit 29 të shtohet neni 29/1, në të cilën parashikohen funksionet e bashkive në fushën e diasporës dhe të migracionit. Këto funksione parashikohet të përfshijnë krijimin e strukturave të posaçme për diasporën dhe migracionin për administrimin e shërbimeve në nivel vendor, si pjesë administrative e njësisë vendore; nxitjen e organizimeve, brenda dhe jashtë vendit, për mbajtjen e komunikimit të vazhdueshëm e forcimin e marrëdhënieve me diasporën dhe migrantët shqiptarë; dhënien e ndihmës e të informacionit për çështje që lidhen me regjistrimin e fitimin e shtetësisë; dhënien e ndihmës e informacionit për legjislacionin shqiptar në fuqi për të interesuarit nga diaspora dhe migracioni, në fushën e investimeve si dhe koordinimin e bashkërendimin e punës me ministrinë përgjegjëse për punët e brendshme, për punët e jashtme dhe për diasporën, për garantimin e dhënies së ndihmës e informacionit për çështjet që lidhen me diasporën dhe migracionin.
- **Në nenin 2** propozohet që në pikën 2, të nenit 12, të përfshihen në konsultimet e njësive të vetëqeverisjes vendore veç shoqatave përfaqësuese dhe grupeve të tjera të interesit edhe përfaqësues të diasporës.
- **Në nenin 3** parashikohet zgjatja e afatit për paraqitjen e raportit për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë.

III. DISKUTIMI NË KOMISION

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në komision nga relatori u vlerësua ndërmarrja e kësaj nisme ligjore, e cila synon synon të nxisë dhe fuqizojë bashkëpunimin në të gjitha fushat me shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe shtetet ku ata banojnë, si dhe të mbrojnë interesat e shtetit brenda fushave të përgjegjesisë.

Deputetët e komisionit u interesuan për ecurinë e deritanishme të strukturave ekzistuese pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, në lidhje me ofrimin e shërbimeve për Diasporën dhe Migracionin dhe për shërbimet specifike të cilave u referohet ndryshimi i propozuar. Për këto

çështje Ministri i Shtetit për Diasporën sqaroi se ndryshimi i propozuar nëpërmjet këtij projektligji si dhe parashikimi i një zyre të veçantë për diasporën dhe migracionin ka për qëllim ofrimin e një asistence të specializuar me informacion të plotë dhe koherent për shtetasit shqiptarë që kthehen dhe duan të rifillojnë një jetë normale në vendlindje, duke qenë se vetëm politika shtetërore qendrore që po aplikohet për këta shtetas është e pamjaftueshme dhe sjell një domosdoshmëri për ngritjen e zyrave të posaçme me personel të kualifikuar për çështjet e diasporës dhe migracionit në nivel lokal, si pika e parë e kontaktit të çdo qytetari. Sa i takon shërbimeve bazike dhe specifike që do të ofrojnë këto zyra, Ministri i listoi këto shërbime si më poshtë:

- Informacion i detajuar mbi mënyrën e fitimit të shtetësisë shqiptare si dhe regjistrimit të shtetasve shqiptarë jashtë vendit;
- Informacion rreth njohjes së diplomave dhe certifikimeve pasur parasysh që anëtarët e diasporës vijnë me një sërë kualifikimesh;
- Informacion rreth njohjes së lejeve të drejtimit dhe konvertimit të tyre;
- Informacione rreth sigurimeve shoqërore dhe skemës së pensioneve apo përfitimeve të ndryshme;
- Informacione të tjera të domosdoshme në shërbim të kësaj kategorie.

Komisioni u ndal në nenin 2 të projektligjit, kërkoi shpjegime për shtesat e propozuara në togfjalëshin “grupet e interesit”, dhe i vlerësoi këto shtesa të panevojshme. Gjithashtu Komisioni e përqëndroi diskutimin edhe në nenin 3 të projektligjit, ku parashikohet të ndryshohet afati për paraqitjen e raportit për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe kërkoi mendimin me shkrim nga Ministria për Ekonominë dhe Financat, duke qenë se ndërhyrja në afatet e raportimeve për veprimtarinë financiare nuk është pjesë e fushës së përgjegjësisë të Ministrisë së Shtetit për Diasporën.

Përfaqësuesi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë sqaroi se Ministria është shprehur pa vërejtje mbi projektligjin, për sa kohë ky projektligj nuk sjell efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit.

Kryetarja e Komisionit kërkoi që një kopje e mendimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë t'i dërgohet komisionit përgjegjës bashkëlidhur me raportin.

Në këtë aspekt duke vlerësuar argumentet e propozuesit si dhe mendimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Komisioni vlerësoi si të argumentuara ndryshimet e parashikuara në projektligj, vlerësoi qasjen e projektligjit dhe shprehu mbështetjen e vazhdueshme për çështjet që lidhen me diasporën dhe migracionin.

IV. REKOMANDIME PËR KOMISIONIN PËRGJEGJËS

Bazuar në çështjet e parashtruara, pyetjet e anëtarëve të komisionit dhe përgjigjet e dhëna nga përfaqësuesit e ministrisë propozuese si dhe nga diskutimi nen për nen i projektligjit, i propozojmë Komisionit përgjegjës sa më poshtë vijon:

- **Neni 2** rekomandojmë të hiqet sepse ligji Nr. 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore” parashikon konsultimin e nismave, politikave dhe legjislacionit që ka ndikim në funksionet e qeverisjes vendore, me shoqatat përfaqësuese të vetë njësisve, duke marrë në konsideratë pikërisht të drejtën e njësisve të vetëqeverisjes vendore për t`u organizuar në shoqata. Në këtë kuadër tashmë janë konsoliduar shoqatat kryesore të cilat përfaqësojnë interesat e njësisve të vetëqeverisjes vendore në tërësinë e funksioneve që kryhen prej tyre referuar neneve (22- 29 të ligjit 139/2015).
- Në **nenin 3**, fjalia “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në fletoren zyrtare”, rekomandojmë të dalë si nen më vete sepse dispozita që përcakton hyrjen në fuqi të aktit duhet të evidentohet në një nen të pavarur.
- Gjithashtu, për **teknikë legjislative** rekomandojmë rregullimin e bazës ligjore në **preambulë** duke e saktësuar atë si më poshtë:
 - “Në mbështetje të neneve 13, 78, 81, pika 2, 83, pika 1 dhe 108-115 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,” si dhe;
 - “Në ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:”

V. PËRFUNDIME

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Politikën e Jashtme, pasi vlerësoi se:

- a) *Në aspektin ligjor*, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;
- b) *Në aspektin procedural*, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm e miratoi atë, dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

RELATOR

KRYETARE

ADNOR SHAMETI

MIMI KODHELI